



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI JURIDIK

Rr. Agim Ramadani, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 229 063 • E-mail: juridiku@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Dekani
Prof. Ass. Dr. Haxhi Gashi

Nr. prot: 04/1841
Datë: 18/07/2016

Në bazë të nenit 66, 72 dhe 76 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, Këshilli i Fakultetit Juridik, në mbledhjen e mbajtur me datë 07.07.2016, mori këtë:

V E N D I M

Për hartimin testeve dhe vlerësimin e studentëve në provime

1. Testet për vlerësimin e studentëve në provime duhet të hartohen në mënyrën që e pasqyrojnë dijen e studentit për lëndën dhe të përmbajnë:
 - Një numër të pyetjeve me alternativa, ku duhet të caktohet përgjigjja e saktë;
 - Një numër të pyetjeve të hapura në formë eseje;
 - Të përfshijë rast studimi për lëndët e lidhura me ligjet pozitive. Raste studimi mund të përmbajnë edhe testet e lëndëve tjera që nuk kanë në përmbajtje ligjet pozitive.
2. Testi duhet të përmbajë numrin e pikëve për secilën pyetje dhe numrin e pikëve për kalueshmëri në provim;
3. Pas shpalljes së rezultateve të provimeve, dhe para se të mbyllen notat në SEMS, duhet të mbahen konsultimet me studentë lidhur me testin e provimit dhe të mbyllet nota në SEMS;
4. Mbajtja e provimeve me gojë nuk përjashtohet me këtë vendim. Mësimdhënësit mund të mbajnë edhe provime me gojë sipas Statutit.

Arsyetim

Me qëllim të rritjes së cilësisë në mësimdhënie-nxënie, transparencën në provime dhe standardizimin e testeve për vlerësimin e njohurive të studentëve në provim, Këshilli i Fakultetit vendosi që testet e provimeve të kenë një formë dhe përmbajtje të caktuar që reflekton cilësi.

Me këtë vendim plotësohen edhe kërkesat e studentëve për të ditur paraprakisht mënyrën e vlerësimit, transparencën e pikëve në test dhe vlerësimin.

Andaj, siç u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi ti dërgohet:

1. Mësimdhënësve;
2. Prodekanit/es për mësim;
3. Prodekanit/es për cilësi;
4. Shërbimit të studentëve të Fakultetit;
5. Të shpallet në ueb- faqe të Fakultetit dhe
6. Arkivit të Fakultetit


DEKANI
Prof. Ass. Dr. Haxhi Gashi